



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration*

RAPORTI VJETOR I FUNKSIONIMIT TË KOMUNAVE

Janar-Dhjetor 2014

Prishtinë, Prill 2015

SHKURTESAT

AKP	-	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
KAB	-	Komiteti për Auditim të Brendshëm
KKSB	-	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KPF	-	Komiteti për Politikë dhe Financa
LVL	-	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MAPL	-	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
NJAB	-	Njësia e Auditorit të Brendshëm
OJQ	-	Organizatë Jo-qeveritare
UA	-	Udhëzim Administrativ
PAK	-	Personat me Aftësi të Kufizuar
PVMSA	-	Plani komunal për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit
PPP	-	Partneriteti Publiko - Privat
SMPSHK	-	Sistemi i Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale
SIMFK	-	Sistemi Integruar i Menaxhimit të Financave
RAE	-	Romë, Ashkali dhe Egjiptian

HYRJE

Raporti vjetor i monitorimit të punës dhe funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës është dokument obligues që rrjedh nga Ligji Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, respektivisht neni 86 i këtij ligji, i cili obligon ministrinë që të bëjë publik një raport të tillë dhe të njëjtin t’ia vë në dispozicion Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, lidhur me monitorimin dhe mbikëqyrjen e komunave.

Ky raport është publik i cili përgatitet çdo vit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i cili bazohet në veprimtarinë njëvjeçare të organeve komunale dhe paraqet punën e komunave, të monitoruar nga MAPL.

Ky raport, nënvizon dhe vlerëson progresin në Komuna por edhe evidenton sfidat në realizimin e obligimeve ligjore të komunave përballë ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

Ky raport është i ndarë në katër pjesë kryesore: Pjesa e parë paraqet aktivitetet e organeve të komunave; Pjesa e dytë vlerëson performancën e ofrimit të shërbimeve komunale; Pjesa e tretë trajton përmbushjen e obligimeve të komunave nga agjenda Evropiane si dhe Pjesa e katërt paraqet nivelin e realizimit të buxheteve të komunave.

PJESA 1

Monitorimi i funksionimit të organeve komunale

1.1. KUVENDET E KOMUNAVE

Kuvendi i Komunës si organi më i lartë i komunës përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët. Kuvendi është organ përgjegjës për miratimin e akteve juridike nënligjore të cilat sigurojnë mbarëvajtjen dhe funksionimin efikas të komunës. Për të ushtruar funksionet e tij, kuvendi i komunës mbledhet në baza të rregullta periodike, por edhe në mbledhje të jashtëzakonshme dhe urgjente.

Pas zgjedhjeve lokale të mbajtura në fund të vitit 2013, në fillim të vitit 2014, ashtu sic parashihet me legjislacionin në fuqi, janë konstituuar kuvendet e 38 komunave të republikës së Kosovës.

1.1.1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Kuvendet e komunave duhet të mbajnë së paku 10 mbledhje në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit.¹ Sipas të dhënave, të gjitha komunat kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e 10 mbledhjeve gjatë vitit.

Në vijim kemi paraqitur grafikun me numrin e mbledhjeve të kuvendeve të komunave:




Fig.1. Numri i mbledhjeve të kuvendeve të rregullta, jashtëzakonshme dhe urgjente

¹ Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.

Nga figura 1 shihet se numrin më të madh të mbledhjeve e kanë mbajtur kuvendet e komunave: Istog, Gjilan, Obiliq, Malishevë, Rahovec, Pejë, Prizren, Mamushë dhe Mitrovicë Jugore.

Në tërësi kuvendet e komunave kanë mbajtur 472 mbledhje.




Fig.2. Numri i përgjithshëm mbledhjeve të kuvendeve të komunave

Sa i përket llojit të mbledhjeve, gjithsej janë mbajtur 406 mbledhje të rregullta, 64 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 2 mbledhje urgjente.

Në të gjitha rastet, mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun, por interesimi i qytetarëve nuk është parë të jetë i shprehur. Dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për arsye specifike lejojnë komunat të përjashtojnë publikun nga mbledhjet e kuvendit. Gjatë vitit 2014 janë marrë dy vendime nga kuvendet e komunave për përjashtim të publikut, një rast në Kuvendin e Komunës së Malishevës dhe një në Komunën e Skenderajt.

Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës dhe prezencës fizike të monitoruesve. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 2012/01 për monitorim elektronik të kuvendeve të komunave, komunat janë të obliguara të sigurojnë qasje në sistemin e teleprezencës. Gjatë kësaj periudhe, ky sistem në disa raste nuk ka funksionuar në komunën e Pejës, Prishtinës, Suharekës, Gllogocit, Shtërpcës dhe Klinës, ndërsa, ky sistem ende nuk është instaluar në komunat: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

1.1.2. Njoftimet për mbledhje dhe materialet përcjellëse

Lidhur me njoftimin e MAPL-së për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, në disa raste komunat nuk kanë dërguar me kohë ftesën për mbledhje të kuvendit (Junik, Malishevë dhe Obiliq). Edhe pse të obliguara me nenin 43.3 (pika e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në disa raste komunat kanë dështuar që së bashku me ftesën për mbledhje të dërgojnë edhe materialet përcjellëse në organin mbikëqyrës. Në këtë grup të komunave bëjnë pjesë: Deçani, Fushë Kosova, Gjakova, Skenderaj dhe Gllogoci.

1.2. Komitetet e përhershme

Pas konstituimit të kuvendeve të komunave janë themeluar komitetet e përhershme, si mekanizma mbështetës për punën e kuvendeve të komunave. Këto komitete janë themeluar në të gjitha komunat, me përjashtim të komitetit për komunitete i cili nuk është themeluar në Komunën e Mitrovicës Veriore. Në vijim është paraqitur numri i takimeve të këtyre komiteteve:




Fig.3. Numri i mbledhjeve të komiteteve të obligueshme sipas komunave

Sipas të dhënave, numrin më të madhe të mbledhjeve të KPF-së e kanë mbajtur komunat: istog, Prizren, Vushtrri, Kamenicë, Hani i Elezit, Malishevë, Mitrovicë Jugore, Podujevë dhe Fushë Kosovë, ndërsa Komiteti për Komunitete më së shumti ka mbajtur mbledhje në komunat: Malishevë, Obiliq, Kamenicë, Dragash, Vushtrri dhe Deçan. Komiteti për Komunitete nuk ka qenë funksional në Komunën e Zveçanit, kurse më pak aktiv është treguar në komunat: Viti, Kaçanik, Glogoc, Leposaviq, Zubin Potok, Hani Elezit, Prizren, Mitrovicë veriore, Junik, Lipjan dhe Gjakovë.




Fig.4. Figura krahasuese e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së

Nga figura nr.4 vërejmë se numri i përgjithshëm i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa është 365, kurse 272 i Komitetit për komunitete. Shihet se komiteti për komunitete në komuna ka treguar performancë më të ulët në krahasim me komitetin për politikë dhe financa.

Mbledhjet e komiteteve duhet të mbahen para mbledhjeve të kuvendeve të komunave, duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ku përfshihen: shqyrtimi i agjendës së propozuar nga kryetari i komunës dhe kryesuesi i kuvendit, ofrimi i rekomandimeve, shqyrtimi i propozim-akteve dhe çështjeve të tjera të cilat parashihen për tu trajtuar në mbledhjet e kuvendit të komunës. Nëse krahasojmë numrin e mbledhjeve të kuvendeve të komunave me numrin e mbledhjeve të komiteteve të përhershme, atëherë del që komitetet për politikë dhe financa kanë mbajtur 107 mbledhje më pak se kuvendet e komunave, kurse 200 mbledhje më pak kanë mbajtur komitetet për komunitete.

1.3. Komitetet tjera

Komunat mund të themelojnë komitete të tjera për të cilat konsiderojnë se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësiave të tyre². Gjatë kësaj periudhe është parë se një pjesë e madhe e komunave kanë themeluar komitete të tjera. Këto komitete janë themeluar për sektorë të ndryshëm, e kryesisht për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, arsim dhe kulturë, zhvillim ekonomik, planifikim urban, kadastër dhe mbrojtjen e mjedisit, shërbime publike, të drejta të njeriut etj. Në vijim në formë grafike kemi paraqitur numrin e komiteteve të tjera të themeluara në komuna:




Fig.5. Numri i komiteteve të tjera në komuna sipas fushave

²Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 51.2

Sipas të dhënave del që nevoja për themelimin e komitete të tjera, e në veçanti komiteteve në fushën e arsimit ka qenë më e madhe në komuna. Komitetet për arsim janë themeluar në 12 komuna, si në: Prishtinë, Lipjan, Klinë, Pejë, Prizren, Skenderaj, Gjilan, Malishevë, Vushtrri, Deçan; Komiteti për Shëndetësi në 10 komuna (Lipjan, Klinë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Malishevë, Vushtrri , Gjilan dhe Partesh); pastaj Komiteti për Planifikim Urban në 9 komuna (Lipjan, Klinë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Malishevë, Gjilan); Komiteti për Shërbime Publike në 9 komuna (Klinë, Junik, Mitrovicë Jugore, Shtime, Prishtinë, Rahovec, Gjilan, Ranillug dhe Partesh); Komiteti për Zhvillim Ekonomik në 7 komuna (Klinë, Pejë, Ferizaj, Prishtinë, Skenderaj, Vushtrri , Gjilan).

Përveç të drejtës për themelimin e komiteteve, kuvendet e komunave mund të delegojnë përgjegjësinë për nxjerrjen e vendimeve në komitete (neni 40.3 i LVL-së), me përjashtim të përgjegjësive të cilat janë të rezervuara ekskluzivisht për kuvendin e komunës sipas nenit 40.2 të LVL-së. Duke u mbështetur në nenin 40.3 të LVL-së, Komuna e Gjakovës ka themeluar Komitetin për shndërrimin e tokës bujqësore në jobujqësore, me të drejtën për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për këtë qëllim. Më poshtë, është paraqitur tabela me llojet e komiteteve të tjera të cilat janë të themeluara në komuna:

Tab.1: Llojet e komiteteve të tjera të themeluara në komuna

Komitetet tjera	Shëndetësi	Shërbime publike	Arsim	Planifikim Urban	Pronë	Zhvillim ekonomik	Bujqësi	Barazi Gjinore	Kulturë, Rini, Sport	Kategoritë e dala	Komiteti për shndërrimin e tokës bujqësore në	Drejta të njeriut	Banim social	Bashkëpunim bashkëpunim
Lipjan	1		1	1			1							
Klinë	1	1	1	1	1	1								
Pejë	1		1	1		1								
Prizren			1	1				1					1	
Deçan			1										1	
Junik		1												
Ferizaj	1		1	1		1			1	1				
Mitrovic ë Jugore	1	1	1	1				1	1					
Shtime		1												
Prishtinë	1	1	1	1	1	1								
Skender aj			1			1								
Glllogoc												1		
Malishev ë	1		1	1										
Vushtrri	1		1			1			1					
Rahovec		1												
Gjakovë											1			
Gjilan	1	1	1	1	1	1		1	1					1
Total	9	7	10	9	3	7	1	3	4	1	1	1	2	1

1.4. Komitetet Konsultative

Sipas LVL-së, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e obligueshme konsultative për të mbështetur punën e tyre. Këto komitete duhet të themelohen për sektorë specifik të përcaktuara nga komuna, sipas prioriteteve dhe me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Sipas të dhënave, vendimet për themelimin e komiteve konsultative janë miratuar në këto komuna: Lipjan, Klinë, Viti, Kamenicë, Podujevë, Hani i Elezit, Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Shtime, Skenderaj, Novobërdë, Gjakovë dhe Gjilan.




Fig.6. Numri i komiteve konsultative në komuna sipas fushave

Tek komitetet konsultative, komunat janë përqendruar më tepër në fushën e zhvillimit ekonomik, arsimit dhe shërbimeve publike. Edhe pse të obligueshme, numri i komunave të cilat kanë themeluar komitete konsultative nuk është i madh. Sipas të dhënave, në 18 komuna janë themeluar gjithsej 37 komitete konsultative, kurse më së shumti janë themeluar në komunat: Viti, Mitrovicë Jugore dhe Gjakovë.

Në vijim është paraqitur tabela me llojet dhe numrin e komiteteve konsultative të themeluara në komuna:

Tab.2: Komitetet konsultative të themeluara në komuna

Komitetet Konsultative	Shëndetësi	Shërbime publike	Arsim	Planifikim Urban	Pronë	Zhvillim ekonomik	Bujqësi	Barazi Gjinore	Kulturë, Rini, Sport	Kategoritë e dala nga lufta	Komiteti për shndërrimin e tokës	Drejta të njeriut	Banim social
Lipjan						1				1			
Klinë								1	1				
Viti		1		1	1	1				1			
Kamenicë													
Podujevë			1									1	1
Hani i Elezit				1	1		1			1			
Ferizaj		1	1	1							1		
Mitrovicë Jugore			1	1	1	1	1						
Shtime	1		1										
Skenderaj			1							1			1
Novobërdë						1							
Gjakovë		1	1		1	1	1						
Gjilan	1												
Gjithsej	2	3	6	4	4	5	3	1	1	4	1	1	2

1.5. Takimet publike me qytetarë



Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin vendimmarrës është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin për vetëqeverisje lokale. Komunat janë të obliguara të respektojnë parimet kushtetuese dhe dispozitat ligjore për të siguruar pjesëmarrje aktive të qytetarëve në procesin vendimmarrës, përmes komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, diskutimeve publike me rastin e propozimit të akteve komunale, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër me të cilën transparenca do të ndikoj në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Organizimi i takimeve publike me qytetarë dallon nga njëra komunë në tjetrën. Disa komuna i kanë kushtuar më tepër rëndësi organizimit të takimeve publike me qytetarë, e disa të tjera kanë qenë të rezervuara në këtë drejtim. LVL, në mënyrë të veçantë ka specifikuar konsultimet gjithëpërfshirëse, ku kërkohet mbajtja e së paku dy takimeve publike brenda një viti (neni 68.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale). Të dhënat e në vijim tregojnë numrin e takimeve të organizuara me qytetarë:




Fig.7. Numri i takimeve publike me qytetarë në komuna

Siç shihet nga figura e mësipërme, shumica e komunave qëndrojnë brenda normës ligjore të përcaktuar, me përjashtim të Komunës së Fushë-Kosovës e cila nuk ka mbajtur asnjë takim publik me qytetarë. Gjithashtu, Komunat: Suharekë, Novobërdë, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë Veriore, nuk kanë mbajtur numrin prej 2 takimeve ashtu siç përcaktohet me nenin 68.1 të LVL-së. Në tërësi janë mbajtur 83 takime me qytetarë.

1.6. Raportimi i kryetarit në Kuvendin e Komunës



Në mesin e përgjegjësive të kryetarit të komunës është edhe raportimi para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese. Kjo detyrë duhet të përmbushet së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës (neni 58, pika j e LVL-së). Raportimi i kryetarit është formë e bashkëpunimit me kuvendin e komunës dhe mundëson funksionimin komplementar të dy organeve.

Nga të dhënat e mbledhura për numrin e raportimeve të kryetarëve në kuvendet e komunave, del që në 38 komuna janë bërë gjithsej 88 raportime. Më hollësisht, numri i raportimeve është si vijon:



Fig.8. Numri i raportimeve të kryetarëve të komunave

Nga figura e mësipërme shihet se kryetarët e komunave: Klinë, Novobërdë, Zubin Potok, Partesh, Graçanicë dhe Killokot nuk e kanë përmbushur obligimin për raportim në kuvendin e komunës së paku dy herë brenda vitit.

Forma të tjera të raportimit kanë qenë me shkrim dhe ato verbale, të cilat janë prezantuar para anëtarëve të kuvendit. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj kuvendit të komunës.

1.7. Aktet e kuvendeve të komunave

Kuvendi i komunës është kompetent apo ka përgjegjësi për miratimin e akteve për zbatimin e ligjeve që prekin kompetencat e komunave. Kuvendi miraton Statutin dhe Rregulloren e Punës, vendime, rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, miraton buxhetin, themelon komitetet e duhura, miraton çështje financiare, zgjedh kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe nënkryetarët (e komuniteteve), si dhe shumë akte të nevojshme për funksionimin efikas të komunës.



Në periudhën janar-dhjetor 2014, kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 2030 akte, prej të cilave 6 Statute të komunave, 148 rregullore dhe 1876 vendime. Vërehet se për nga numri komunat kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore. Aktet e miratuara rregullojnë fushat e ndryshme të qeverisjes në nivelin lokal, prej të cilave mund të përmenden: themelimi i komiteteve të obligueshme,

komiteteve të tjera, KKSb-ve, planeve vjetore të punës, miratimi i planeve rregulluese urbane, miratimi i akteve nga fusha e mjedisit, akteve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, për emërtimin e rrugëve, fushën e shërbimeve publike, akteve të karakterit financiar, pastaj themelimin e komisioneve të ndryshme për nevoja të brendshme etj. Për nga aspekti numerik, në vijim është prezantuar figura e akteve të miratuara sipas komunave:




Fig.9. Numri i akteve të miratuara në kuvendet e komunave

Siç mund të shihet, më aktive në miratimin e akteve komunale kanë qenë komunat: Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Gjilan, Gjakovë, Malishevë, Prishtinë, Kamenicë, Vushtrri, Obiliq, Podujevë dhe Hani i Elezit, kurse më së paku akte kanë nxjerrë kuvendet e komunave: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok, Dragash dhe Junik.

1.8. Funkionimi i faqeve elektronike të komunave

Funksionimi dhe përdorimi i faqeve zyrtare të internetit të komunave rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2011 për Ueb-faqet e institucioneve Publike. Çështjet e tjera të përdorimit të ueb-faqeve zyrtare të komunave që lidhen me transparencën komunale, publikimin e akteve komunale dhe informimin e publikut janë të rregulluara me norma të veçanta të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr.2008/3 për ndryshimin e U.A. Nr.2006/03 për “Transparencën në Komuna” dhe Rregulloren Nr. 01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave.



Referuar këtyre akteve, komunat janë përgjegjëse të respektojnë parimin e transparencës, të krijojnë lehtësira për qasje të publikut në informacionet dhe ngjarjet e komunave, si dhe të krijojnë mundësinë për qasje më të lehtë në dokumentet zyrtare të komunës. Si mjet kryesor për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, janë faqet zyrtare elektronike të komunave. Marrë parasysh se komunat kanë aktivitete të ndryshme futja e të dhënave në faqet zyrtare elektronike të komunave duhet të jetë e vazhdueshme.

1.8.1. Publikimi i akteve në faqet zyrtare elektronike të Komunave

Përgjegjësia për publikimin e akteve të Komunave dhe përditësimin e faqeve elektronike zyrtare të komunave me aktet juridike të miratuara është rregulluar me Rregulloren Nr. 01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave. Gjatë kësaj periudhe raportuese, përditësimi i faqeve elektronike të komunave me aktet e miratuara nuk ka qenë koherent. Më poshtë është paraqitur grafiku me të dhënat sipas komunave, lidhur me publikimin e akteve në faqet elektronike:




Fig.10. Numri i akteve të miratuara në kuvendet e komunave

Nga të dhënat e prezantuara shihet se një pjesë e madhe e akteve komunale nuk janë publikuar në faqet zyrtare elektronike. Për nga numri, nuk janë publikuar 647 akte në shqip, kurse 1379 në gjuhën serbe. Mesatarja e publikimit të akteve të kuvendeve në gjuhën shqipe është 67%, kurse në gjuhën serbe 32%.

Sipas kësaj vërejmë që publikimin e akteve në gjuhët zyrtare nuk kanë arritur të përmbushin komunat: Prishtinë, Klinë, Mamushë, Deçan, Junik, Viti, Podujevë, Hani i Elezit, Kaçanik, Shtime, Skenderaj, Glllogoc, Suharekë, Obiliq, Malishevë, Vushtrri, Novobërdë, Leposavic, Zvečan, Mitrovicë Veriore, Rahovec, Gjakovë, Gjilan dhe Partesh. Kurse komunat të cilat kanë treguar performancë të mirë në këtë drejtim janë: Prizreni, Kamenica, Ferizaj, Graçanica dhe Mitrovica Jugore. Krahas komunave në të cilat janë aktive ueb-faqet zyrtare, komunat të cilat nuk i kanë funksionalizuar ueb-faqet janë: Mitrovica Veriore, Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan dhe Partesh.

1.9. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi



Në nivelin lokal, trupa me rëndësi për sigurinë publike të qytetarëve por edhe më gjerë janë Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB). Themelimi i KKSB-së bazën ligjore e ka me Ligjin për Policinë, ndërsa përbërja, mënyra e funksionimit dhe obligimet tjera fillimisht janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL.

Me ndryshimet e bëra me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, është definuar edhe më qartë pozicioni i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në raport me komunën. Edhe me këto ndryshime normative është përcaktuar roli preventiv i këtij Këshilli ndaj dukurive negative në shoqëri dhe janë përcaktuar një numër i objektivave me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për natyrën e krimeve, parregullsive dhe sjelljeve të dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave të qytetarëve dhe përfaqësimit e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve për çështjet e krimit.

1.9.1. Takimet e mbajtura të KKSB-ve dhe çështjet e shqyrtuara

Me udhëzimin administrativ për KKSBB, ndër të tjera është rregulluar edhe numri minimal prej gjashtë takimeve në vit, tri prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmuorin e parë³. Për numrin e takimeve, është paraqitur skema në vijim:




Fig.11. Numri i takimeve të KKSBB-së sipas komunave

Për nga numri i takimeve, më aktiv ka qenë Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në komunën e Hanit të Elezit, me gjithsej 11 takime të mbajtura. Komunitat të cilat kanë mbajtur nga 6 takime ashtu siç parashihet me udhëzimin administrativ, janë: Istog, Pejë, Viti, Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Shtime, Prishtinë, Glllogoc, Malishevë, Vushtrri, Gjilan dhe Klllokot. Komunitat të cilat kanë dështuar në përmbushjen e numrit minimal prej 6 takimeve në vit janë: Lipjan, Klinë, Prizren, Mamushë, Deçan, Junik, Kamenicë, Podujevë, Fushë-Kosovë, Kaçanik, Skenderaj, Suharekë, Dragash, Obiliq, Novobërdë, Rahovec, Gjakovë, Ranillug, Partesh, Graçanicë dhe Shtërpcë. Pra nga 34 komuna të cilat i kanë të themeluara KKSBB-të, 13 prej tyre kanë përmbushur normën minimale prej 6 takimeve apo 39 %, kurse 21 komuna kanë dështuar në mbajtjen e takimeve ose shprehur në përqindje 61%. Për dallim nga to, Komunitat: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok ende nuk i kanë miratuar vendimet për themelimin e KKSBB-ve. Duke marrë parasysh natyrën për të cilën veprojnë këto këshilla, gjatë periudhës janar-dhjetor 2014, temat të cilat më së shumti janë trajtuar kanë të bëjnë me: veprat penale kundër pasurisë, përdorimin e armëve nëpër ahengje, sigurinë në komunikacion, qentë endacak, mbeturinat në rrugë, ndriçimin publik, lëmshë-kërkuesit, vjedhjen e pyjeve etj.

³ Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, neni 11.2.

Tab.3: Çështjet më të trajtuara në takimet e KKSB-ve në komuna

<u>Komunat</u>	<u>Temat e mbuluara</u>	<u>Rezultatet</u>
KKSB	- Veprat penale kundër pasurisë	- Ndërmarrja e veprimeve policore, shtim i kontrolleve të policisë, konfiskimi i armëve. inkurajimi i qytetarëve për të bashkëpunuar me policinë, informimi i menjëhershëm i rasteve
	- Rrahjet për motive pasurore,	- Patrullimi i policisë, kontrolli i automjeteve
	- Përdorimi i armëve nëpër ahengje	- Gatishmëri më e madhe e njësitit të zjarrfikësve
	- Siguria në komunikacion	- Sterilizimi dhe kastrimi i qenve
	- Zjarret	- Bashkëpunimi me qytetarë
	- Qentë endacak	- Prioritet më i madh por të vetëdijësuar të rinjtë nga dukuritë negative
	- Përdorimi i narkotikëve nga të rinjtë	- Vendorsja e shportave nëpër rrugë, angazhim më i madh i kompanisë së kontraktuar, përmbushja e detyrimeve të pagesave për mbeturina nga qytetarët; Shqyrtimi i çështjes në Drejtorinë për Shërbime Publike; Sigurimi dhe organizimi i transportit nga fshatrat deri në qytet dhe anasjelltas
	- Mbeturinat në rrugë	- Prioritet i komunës për ndërtimin e trotuareve; ndihmesë nga policia në vendosjen e shenjave sinjalizuese
	- Mungesa e transportit për zonat rurale	- Shtim i patrullimit në këmbë të policisë nëpër qytet;
	- Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese	
	- Kontrabanda me narkotik	

1.10. Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve për të cilat shprehimisht nuk është kompetent ndonjë autoritet tjetër. Komunitet kanë përgjegjësi që sipas nenit 80 të LVL-së të dërgojnë aktet e miratuara nga kuvendi për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës. Gjatë vitit 2014 komunitet

kanë dërguar aktet e miratuara për vlerësim të ligjshmërisë në MAPL. Mirëpo, shumica e kryetarëve të komunave nuk kanë dërguar listën e të gjitha akteve të miratuara nga kryetari dhe kuvendi i komunës, sipas nenit 80.1 të LVL-së. Në këtë aspekt, si shembull i mirë duhet të merret Komuna e Gjilanit, Prizrenit dhe Mitrovica Jugore të cilat kanë dërguar listën me aktet e miratuara.



1.10.1. Shkeljet ligjore të evidentuara

Sa i përket shkeljeve ligjore të kuvendeve të komunave me rastin e nxjerrjes së akteve nënligjore, në vijim është paraqitur grafiku me të dhënat e përgjithshme:




Fig.12. Numri i përgjithshëm i shkeljeve të konstatuara

Pra, siç vërejmë shkelje kanë bërë gjithsej 28 komuna. Numri i akteve të kundërligjshme është 52, prej të cilave 35 akte janë të rishqyrtuara dhe të harmonizuara me ligj, 12 akte nuk janë rishqyrtuar sipas kërkesës për rishqyrtim, kurse 5 akte nuk janë harmonizuar edhe pas rishqyrtimit në kuvend.

Më poshtë, është prezantuar figura më e detajuar me numrin e shkeljeve të konstatuara nga MAPL, të akteve të kuvendeve të komunave dhe veprimet e komunave në raport me respektimin e ligjshmërisë:



Fig.13. Numri i shkeljeve të konstatuara dhe veprimet e komunave për harmonizimin e tyre

Nga figura e mësipërme del që komunat të cilat nuk i kanë rishqyrtuar aktet e kundërligjshme janë: Peja (1 vendim), Parteshi (2), Mitrovica Veriore (1), Ferizaj (1), Suhareka (1), Deçani (1), Malisheva (1) dhe Prishtina (1). Krahas tyre, komuna e Pejës (në 4 raste) dhe Lipjani (në 1 rast), edhe pas rishqyrtimit të akteve në kuvendin e komunës, kanë vendosur në mënyrë të njëjtë, duke fuqizuar vendimet e mëparshme të cilat janë konsideruar të kundërligjshme nga MAPL.

1.10.2. Natyra e shkeljeve ligjore

Shkeljet ligjore të cilat janë evidentuar me rastin e miratimit të akteve nga kuvendet e komunave kanë qenë të ndryshme. Në shumë raste komunat kanë nxjerrë akte pa përfillur procedurat ligjore dhe dispozitat materiale. Numri më i madh i akteve të kundërligjshme janë miratuar me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, apo vendimeve të cilat kanë pasur për qëllim kthimin e pronave të cilat menaxhohen nga AKP.

Komunat, në disa raste kanë shkelur edhe kriteret për caktimin e pozitave të ndryshme politike, siç është rasti i pozitës së zëvendës-kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete, ku nuk është marrë parasysh kriteri ligjor prej 10% e komuniteteve jo shumicë në nivelin lokal. Çështje të tjera të cilat janë evidentuar nga MAPL, kanë të bëjnë me procedurën e miratimit, ndryshimit dhe plotësimit të statuteve të komunave dhe akteve të tjera nënligjore. Sa i përket numrit të shkeljeve sipas llojit, më poshtë është paraqitur skema grafike, si vijon:



Fig.13. Natyra e shkeljeve ligjore

Vërejmë se numri më i madh i shkeljeve në komuna ka të bëjë me procedurat e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim. Këto shkelje janë bërë nga kuvendet e komunave: Rahovec, Kamenicë, Pejë, Klinë, Graçanicë, Skenderaj, Lipjan dhe Glllogoc. Prej tyre, 10 vendime janë harmonizuar nga komunat, me përjashtim të 2 vendimeve të Komunës së Lipjanit dhe 4 vendimeve të Kuvendit të komunës së Pejës, të cilat nuk janë rishqyrtuar dhe harmonizuar me ligj. Gjithashtu, një numër i komunave si: Zubin Potok, Graçanicë, Zveçan, Kamenicë, Pejë dhe Partesh, kanë zgjedhur zëvendëskryesuesit e kuvendit të komunës për komunitete në kundërshtim me dispozitat e LVL-së. Një numër i madh i shkeljeve është vërejtur edhe me rastin e miratimit apo plotësimit-ndryshimit të Statutit të komunave, si dhe me rastin e themelimit të komiteve të kuvendit apo komisioneve të ndryshme.

Për më saktë, në shtojcën 1 është paraqitur tabela e shkeljeve ligjore për secilën komunë, si dhe veprimet e komunave me qëllim të rishqyrtimit dhe harmonizimit të akteve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË KOMUNAVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE PËR QYTETARË


2.1. PERFORMANCA E KOMUNAVE SIPAS FUSHAVE PËRKATËSE

Aktualisht SMPSHK bën matjen e 15 fushave të ndryshme themelore nga kompetencat vetanake të komunave. SMPSHK funksionon dhe siguron matjen e performancës në secilën fushë duke u bazuar në rezultatet dhe treguesit përkatës. Fushat themelore për të cilat bëhet matja e performancës së komunave janë: Shërbimet Administrative; Mirëqenie Sociale; Kulturë, Rini dhe Sport; Menaxhimi i Emergjencave Lokale; Planifikimi Urban; Parqet dhe sheshet; Rrugët; Trotualet; Transporti publik komunal; Parkingjet publike; Ndriçimi Publik; Furnizimi me ujë; Kanalizimi dhe higjiena publike; Grumbullimi i mbeturinave dhe Deponimi i mbeturinave të ngurta.

Secila fushë e shërbimit ofrohet në kuadër të një strukture organizative apo drejtorie. Në përputhje me kompetencat që ka komuna, administrata komunale ofron 29 lloje të ndryshme të shërbimeve. Komunat nuk kanë themeluar 29 drejtori, por shërbimet me natyrë të përafërt i kanë organizuar në kuadër të një drejtorie përkatëse. Numri më i madh i punonjësve të administratës lokale, deri në 23% e tyre, punojnë në drejtorinë e administratës, 16% e të punësuarve punojnë në drejtorinë e shërbimeve publike dhe 60% e të punësuarve tjerë janë të shpërndarë, mesatarisht nga 8.6% në 7 drejtoritë tjera.

Drejtorati i prokurimit është më i vogli me vetëm 61 të punësuar ose 0.9%.

Fig. 14. Shpërndarja e kapaciteteve njerëzore sipas drejtorive të komunave për ofrimin e shërbimeve përkatëse⁴



⁴ MAPL, Dokument Analizë: Kriteret e Madhësisë së Administratës Lokale, 2014, Prishtinë

2.2. PERFORMANCA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR QYTETARËT

Në bazë të shënimeve zyrtare, nga numri total prej 38 komunave, kanë raportuar gjithsej 37 komuna⁵. Të dhënat janë raportuar sipas sistemit të menaxhimit të performancës, të vendosur nga MAPL, për 15 fusha të veçanta, që hyjnë në grupin e kompetencave vetanake të Komunave.




Fig. 15. Pasqyra e përgjithshme e performancës së komunave sipas fushave (15)

Bazuar në të dhënat që kanë dërguar Komunitat, shihet se komunitat kanë treguar një shkallë mesatare të performancës në ofrimin e shërbimeve deri në 55%. Për një performancë të shkallës mesatare tregojnë edhe rezultatet e fushave përkatëse: 7 fusha kanë treguar rezultate mbi mesatarën e vendit, 7 fusha janë nën mesatarën e vendit dhe 1 fushë është e barabart me mesatarën e vendit. Ndërkaq, komunitat kanë treguar performancë më të mirë në këto fusha: shërbime administrative (86%), emergjencat lokale (85%), planifikimin urban (66%) dhe transportin publik (61%). Fushat që kanë treguar performancë më të ulët janë: kulturë, rini dhe sport (33%), parqet dhe sheshet (34%), ndriçim publik (34%) dhe deponimi i mbeturinave (46%). Në raport nuk është pasqyruar shkalla e performimit sipas komunave.

2.3. Pasqyrimi i të dhënave të raportuara

Prej 38 komunave, 35 komuna kanë raportuar sipas kohës së planifikuar me SMPSHK, 2 komuna kanë raportuar me vonesë dhe 1 komunë nuk ka raportuar fare. Pasqyrimi i të dhënave i ka parapritë një fazë e përpunimit dhe e verifikimit të tyre nga ana e MAPL dhe e komunave. Nga

⁵ Vetëm komuna e Leposaviqit nuk ka raportuar


të dhënat e raportuara është krijuar baza elektronike e të dhënave, nga e cila pastaj është bërë përpunimi i tyre sipas fushave dhe treguesve përkatës. MAPL, aktualisht matë performancën e komunave vetëm për 15 fusha dhe 95 tregues përkatës. Në vazhdim po i pasqyrojmë të dhënat e përpunuara sipas fushave përkatëse.

Shërbimet administrative-përfaqësojnë shtyllën kryesore të ofrimit të shërbimeve për qytetarë nga Komunat. Raporti pasqyron performancën e komunave për një tregues: % e lëndëve të shqyrtuara brenda vitit 2014. Për matjen e këtij teguesi janë mbledhur dy lloje të dhënave: Numri i gjithëmbarshtëm i lëndëve të pranuar dhe Numri i lëndëve të shqyrtuara brenda vitit 2014. Të dhënat pasqyrojnë punën e 35 komunave, ndërsa komunat e Leposaviqit, të Zveçanit dhe të Zubin-Potokut ende janë në proces të përfshirjes në sistemin elektronik CMS/CSC. Për arsye objektive të mungesës së këtij programi në komunat: Graçanicë, Ranillug, Partesh dhe Klllokot, të dhënat për azhuritetin dhe efikasitetin e organeve të këtyre komunave janë siguruar në mënyrë fizike, nga zyrtarët të cilët këto të dhëna i kanë siguruar në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve të këtyre komunave respektive. Në vazhdim të raportit janë të prezantuara të dhënat e përgjithshme për azhuritetin dhe efikasitetin e organeve për komunat e Republikës së Kosovës.

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e lëndëve të pranuar është 49276 kërkesa. Komunat të cilat kanë pranuar numër më të madh të kërkesave janë: Prishtina (288485 kërkesa), Prizreni (185456 kërkesa) dhe Gjlani (143895 kërkesa), ndërsa komunat të cilat kanë pranuar numër më të vogël të kërkesave janë: Parteshi (1975 kërkesa), Klllokoti (3070 kërkesa) dhe mamusha (4479 kërkesa). Mesatarja e përgjithshme e kërkesave të shqyrtuara (miratuara) është 42428 kërkesa. Të dhënat tregojnë se numri më i madh i komunave ka treguar performancë nën mesatarën, në këtë fushë.

Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave sa i përket trajtimit të kërkesave është 86.11% (me 6470 lëndë të pa shqyrtuara). Komunat të cilat kanë shënuar performancë më të lartë janë: Gllogofc (103%), Podujevë, Skënderaj, Shtime, Shterpcë, Viti, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranilluk dhe Zveçan (99%), ndërsa komuna me performancë më të ulët është Novobërda (8%), Kamenica (11%) dhe Deçani (17%). Grupi më i madh i komunave ka arritë performancë mbi 90% apo mbi mesataren e vendit prej 86.11%.


Fig. 16. Performanca e komunave për shërbimet administrative



Mirëqenia sociale-matja e performancës së komunave nga kjo fushë bëhet përmes pesë treguesve: 1) Numri i rasteve të personave me aftësi të kufizuar që janë të punësuar në institucione komunale; 2) Numri i kërkesave për banim/strehim të rasteve sociale dhe njerëzve në nevojë; 3) Numri i familjeve të vendosura në strehimore kolektive; 4) Numri i rasteve nën përkujdesje sociale dhe 5) Numri i ankesave për shërbimet sociale.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve me aftësi të kufizuar në komuna është 122 persona. Komunitat që kanë më së shumti të punësuar janë: Podujeva (28 persona) istogu (14 persona) dhe Ferizaj (13 persona). Komunitat që nuk kanë të punësuar asnjë person me aftësi të kufizuar janë: Gllogofci, Gjilani, Dragashi, Novobërda, Obiliqi, Rahoveci, Shtimja, Peja, Hani i Elezit, Mamusha, Juniku, Kllokoti, Graçanica, Ranillugu, Parteshi dhe Zveçani.

Gjatë vitit 2014 komunitat kanë pranuar gjithsej 2496 kërkesa për banim/strehim. Komunitat që kanë pasë numër më të madh të kërkesave janë: Gjilani dhe Ferizaj (396 - 360 kërkesa), ndërsa komunitat që kanë numër më të vogël të kërkesave janë: Novobërda dhe Vitia (6 – 8 kërkesa) dhe komunitat që nuk kanë pasë asnjë kërkesë janë: Obiliqi, Shtërpca, Mitrovica e Veriut, Hani i Elezit, Mamusha, Juniku, Kllokoti, Ranillugu, Parteshi dhe Zveçani (10 komuna). Në bazë të kërkesave dhe kapaciteteve të komunave janë strehuar gjithsej 997 familje. Komunitat që kanë strehuar më së shumti familje, janë: Graçanica (107 familje), Deçani (86 familje), Podujeva (74 familje) dhe Klina (71 familje), ndërsa komunitat që nuk kanë strehuar asnjë qytetar janë: Dragashi, Novobërda, Obiliqi, Rahoveci, Skenderaj, Shtimja, Suhareka, Mamusha, Juniku, Kllokoti, Ranillugu, Parteshi dhe Zveçani (13 komuna). Mesatarja e përgjithshme e numrit të familjeve të strehuara është 40 familje. Numri më i madh i komunave ka strehuar më pak familje se mesatarja e vendit.



17. Performanca e komunave sipas treguesve social.

Në bazë të skemës sociale të komunave, numri i përgjithshëm i rasteve nën përkujdesje sociale është 33685. Numri më i madh i përfituesve për përkujdesje sociale janë në komunitat: Prishtinë (7202), Mitrovicë (2135) dhe Gjilan - 2082 qytetarë), ndërsa numri më i vogël i qytetarëve që

kanë pas përkujdesje sociale janë në komunat: Mamusha, Parteshi, Dragashi (32 – 35 qytetarë). Mesatarja e përgjithshme e rasteve që janë në përkujdesje sociale është 910 qytetarë.

Komunat me numrin më të madh të ankesave për shërbime sociale janë: Skenderaj (277), Mitrovica (211), Ferizaj (180) dhe Prizreni (176), ndërsa komunat që nuk kanë pasur ankesa janë: Dragashi, Mamusha, Partesh, Kaçaniku dhe Obiliqi.

Kulturë, rini dhe sport-Sa i përket performancës së komunave nga kjo fushë nëpërmjet katër treguesve: 1) *Numri i aktiviteteve komunale në tri sektorët – kulturë, rini dhe sport*; 2) *Objektet sportive në komunë*; 3) *Objektet për aktivitete rinore në komunë*; 4) *objektet për aktivitete kulturore në komunë*.

Numri i përgjithshëm i aktiviteteve për kulturë, rini dhe sport në komuna është 4223. Komunat që kanë më së shumti aktivitete janë: Ferizaj (642 aktivitete) Vitia (430 aktivitete) dhe Fushë-Kosova (428 aktivitete), ndërsa komunat që kanë numrin më të vogël të aktiviteteve në këtë fushë janë: Zveçani (0 aktivitete), Zubin-Potoku, Novobërda, Obiliqi, Hani i Elezit dhe Parteshi (6 – 13). Mesatarja e përgjithshme e numrit të aktiviteteve për rini, sport dhe kulturë në komuna është 117.

Gjatë vitit 2014 komunat kanë ndërtuar gjithsej 426 objekte sportive. Më së shumti objekte sportive ka ndërtuar Komuna e Prishtinës dhe e Gjakovës me 46 objekte, pastaj Fushë-Kosova (25 objekte), Shtimja dhe Graçanica nga 23 objekte, ndërsa komunat që kanë ndërtuar më së paku objekte sportive janë: Novobërda dhe Kllokoti nga 1 objekt, Suhareka dhe Kamenica 3 dhe Deçani, Glllogofci, Obiliqi dhe Mamusha nga 4 objekte. Mesatarja e përgjithshme e numrit të objekteve sportive është 11.83. Shumica e komunave kanë treguar performancë nën mesatarën e vendit. Numri i përgjithshëm i objekteve për aktivitete rinore në komuna është 279.

Komunat që kanë më së shumti objekte për aktivitete rinore janë: Fushë-Kosova (25 objekte) dhe Prishtina (23 objekte), ndërsa komunat që kanë numrin më të vogël të objekteve për aktivitete rinore janë: Skenderaj, Zubin-Potoku (1 objekt), Deçani, Hani i Elezit dhe Mamusha - nga 2 objekte dhe Shtimja e Kllokoti nga 3 objekte. Obiliqi dhe Zveçani nuk kanë objekte për aktivitete rinore. Mesatarja e përgjithshme e numrit të objekteve për aktivitete rinore në komuna është 7.97. Shumica e komunave kanë më pak objekte për aktivitete rinore se mesatarja e vendit.

Numri i përgjithshëm i objekteve për aktivitete kulturore në komuna është 294. Komunat që kanë më së shumti objekte për aktivitete kulturore janë: Fushë-Kosova (25 objekte), Prishtina dhe Podujeva nga 23 objekte, ndërsa komunat që kanë numrin më të vogël të objekteve për aktivitete kulturore janë: Skenderaj (1 objekt), Deçani, Hani i Elezit dhe Mamusha nga 2 objekte dhe Shtimja e Kllokoti nga 3 objekte. Obiliqi dhe Novobërda nuk kanë objekte për aktivitete kulturore. Mesatarja e përgjithshme e numrit të objekteve për aktivitete kulturore në komuna është 8.4. Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave për këtë fushë është 9.40%. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në shtojcën e këtij raporti.




Fig. 18. Performanca e komunave sipas treguesve për kulturë, rini dhe sport.

Menaxhimi i emergjencave lokale- institucionet publike kanë themeluar struktura dhe mekanizma të veçantë për reagime të shpejta. Raporti pasqyron performancën e komunave për pesë tregues:

1) Numri rasteve emergjente - fatkeqësitë (zjarre, vërshime, tërmete); 2) Vlera e pasurisë së humbur gjatë rasteve emergjente në euro në vit; 3) Numri i rasteve emergjente, për të cilat ekipet është dashur të dalin menjëherë në vend të ngjarjes; 4) Koha totale vjetore për arritjen në vend të ngjarjes për të gjitha rastet emergjente në minuta; 5) Koha mesatare e nevojshme për të arritur në vendin e ngjarjes në minuta.


Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se numri i përgjithshëm i rasteve emergjente në komuna është 8395. Komunitat që kanë pasur më së shumti raste emergjente janë: Prishtina (1404 raste), Ferizaj (960 raste) dhe Mitrovica (573 raste), ndërsa komunitat që kanë pasur numrin më të vogël të rasteve emergjente janë: Klllokoti (1 rast), Shterpca (4 raste), Ranillugu (8) dhe Hani i Elezit e Parteshi nga 16 raste. Mesatarja e përgjithshme e numrit të rasteve emergjente në komuna është 233.19.

Gjatë vitit 2014 komunitat nga fatkeqësitë kanë humbur pasuri në vlerë prej 3,485,014.80 euro. Më së shumti humbje ka pasur Komuna e Pejës (522,800,00 euro), e Vushtrrisë (401,770,00 euro) dhe e Istogut (384,000,00 euro), ndërsa komunitat që kanë qenë më së paku të dëmtuara janë: Hani i Elezit (500 euro) dhe Parteshi (6225 euro). Mesatarja e përgjithshme e dëmeve të shkaktuara është 156,423,27 euro. Numri i përgjithshëm i reagimeve të ekipeve emergjente në komuna ka qenë 7107 raste. Më së shumti raste të reagimit ka pasur Komuna e Prishtinës (1404 raste) ndërsa komuna që ka pasur më së paku raste të reagimit të ekipeve emergjente është Klllokoti (1 rast).

Mesatarja e përgjithshme e reagimeve të ekipeve emergjente në komuna është 197.42 raste. Komuna që ka reaguar më së shpejti është Juniku (7.1 minuta), ndërsa komuna më e ngadaltë në reagim ka qenë Komuna e Deçanit (21.39 minuta). Koha mesatare e nevojshme për arritje në vendin e ngjarjes është 17.19 minuta.

Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave për këtë fushë është 84.66%.

Fig. 19. Performanca e komunave në menaxhimin e emergjencave lokale



Planifikimi urban- Shumica e komunave kanë miratuar planet e rregullimit urban ndërsa matja e performancës së komunave në këtë fushë është bërë nëpërmjet tre treguesve: 1) Përqindja e sipërfaqes së tokës/zonës urbane për të cilën ekzistojnë planet rregulluese në ha; 2) % e aktvendimeve të ekzekutuara nga inspekcioni i ndërtimit; 3) % e kërkesave të shqyrtuara për leje ndërtimi.

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se përqindja e përgjithshme e rregullimit të sipërfaqes së zonës urbane në hektar është 49.98 %. Komuna që ka përqindje më të lartë të rregulluar të zonës urbane në hektar është: Klina dhe Shtime (100 %), Prizreni 91% dhe Peja 89.5%. Komunitat që kanë përqindje më të ulët të rregulluar të zonës urbane në hektar janë: Kamenica, Novobërda, Obiliqi, Rahoveci, Shterpca, Mitrovica e Veriut dhe Klllokoti (0 %).

Mesatarja e përgjithshme e përqindjes së ekzekutimit të aktvendimeve të inspekcionit për ndërtim është 58.79%. Komunitat të cilat kanë ekzekutuar përqindje më të lartë të aktvendimeve të inspekcionit për ndërtim janë: Deçani, Fushë-Kosova, Obiliqi, Rahoveci, Shterpca, Juniku, Ranillugu dhe Graçanica (100%), ndërsa komunitat të cilat kanë ekzekutuar përqindje më të ulët të aktvendimeve të inspekcionit për ndërtim janë: Glllogofci, Gjilani, Kamenica, Novobërda, Suhareka, Mitrovica e Veriut, Malisheva, Hani i Elezit, Mamusha, Klllokoti dhe Parteshi (0%).

Përqindja e përgjithshme mesatare e kërkesave të shqyrtuara për leje të ndërtimit është 90.42%. Më së shumti kërkesa ka shqyrtuar komuna e Deçanit, Glllogofcit, Dragashit, Fushë-Kosovës, Novobërdës, Pejës, Prizrenit, Shtimës, Junikut, Klllokotit dhe Graçanicës (100%), ndërsa më së paku kërkesa kanë shqyrtuar komunat e Suharekës, Mitrovicës e Veriut, Malishevës dhe Mamushës (0%). Mesatarja e përgjithshme e performancës së këtij shërbimi është 66.40%.




Fig. 20. Performanca e komunave për planifikimin urban.

Parqet dhe sheshet- Matja e performancës së komunave në këtë fushë është bërë nëpërmjet dy treguesve: 1) Sipërfaqja e parkut/sheshit për kokë banori, në metër katror (m^2); 2) % e parqeve-shesheve komunale me qasje në ujë të pijshëm. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e sipërfaqes së parqeve/shesheve për kokë të banorit është $1.16 m^2$. Komunat të cilat kanë numrin më të madh të sipërfaqeve të parqeve/shesheve për kokë të banorit janë: Prishtina ($5.31 m^2$) dhe Graçanica ($5.02 m^2$), ndërsa komunat të cilat kanë numrin më të vogël të sipërfaqeve të parqeve/shesheve për kokë të banorit janë: Deçani ($0.02 m^2$), Klllokoti ($0.04 m^2$). Shumica e komunave (21) kanë më pak se $1 m^2$ për kokë banori parqe/sheshe.

Mesatarja e përgjithshme e përqindjes së sipërfaqes së parqeve/shesheve me qasje të ujit të pijshëm është 58.85%. Komunat me përqindje më të madhe të qasjes së ujit të pijshëm në parqe/sheshe janë: Glllogofci, Kaçaniku, Fushë-Kosova, Lipjani, Obiliqi, Shterpca, Hani i Elezit, Mamusha, Juniku (100%), ndërsa komunat me përqindje më të ulët të qasjes së ujit të pishëm në parqe/sheshe janë: Kamenica, Novobërda, Mitrovica e Veriut dhe Klllokoti (0%).




Fig. 21. Numri i komunave sipas shkallës së sipërfaqës së parkut /sheshit për kokë të banorit dhe mesatarja e përgjithshme e komunave me sipërfaqe të parqeve dhe shesheve për kokë banori

Rrugët- Ofrimi i këtij shërbimi është i ndërlidhur edhe me nivelin qendror, pasi që rrugët lokale janë të lidhura dhe të ndërlidhura edhe me rrugët rajonale duke krijuar sistemin rrugor. Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet tre treguesve: 1) % e km të

rrugëve, të përfshira në planin komunal për pastrim / fshirje / larje; 2) % e rrugëve lokale në komunë, që janë të asfaltuara dhe 3) % e km rrugë, të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve.

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e përqindjes së km rrugë të planifikuara për pastrim është 33.85%. Komunitet të cilat e kanë përqindjen më të lartë të km rrugë të planifikuara për pastrim janë: Kllokoti, Graçanica, Parteshi (100%) dhe Hani i Elezit (81.97%), ndërsa komunitet me përqindje më të ulët të km rrugë të planifikuara për pastrim janë: Novobërda 1.9% dhe Lipjani 1.3%. Shtërpsa nuk e ka të planifikuar asnjë km rrugë për pastrim.

Mesatarja e përqindjes së rrugëve në km të asfaltuara në komuna është 59.91%. Komunitet të cilat kanë përqindjen më të lartë të rrugëve të asfaltuara në km janë: Shtërpsa 100%, Graçanica 96.14%, Parteshi 84.27% dhe Hani i Elezit 81.97%.

Gjithashtu komunitet bëjnë mirëmbajtjen e rrugëve, në veçanti gjatë dimrit. Mesatarja e përqindjes së km rrugë të përfshira në mirëmbajtjen dimërore është 74.20%. Komunitet të cilat kanë përqindjen më të lartë të rrugëve të planifikuara për mirëmbajtje gjatë dimrit në km janë: Podujeva, Skenderaj, Ferizaj, Mitrovica e Veriut, Kllokoti, Ranillugu dhe Parteshi (100% km), ndërsa komunitet të cilat kanë përqindjen më të ulët të rrugëve të planifikuara për mirëmbajtje në km janë: Lipjani (25%) dhe Zveçani (23%). Numri më i madh i komunave ka treguar performancë mbi mesataren e vendit.

Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave për këtë fushë është 55.99%.




Fig. 22. Performanca e komunave sipas treguesve për rrugët.

Trotuaret- Komuna është e obliguar që t’u sigurojë hapësirë të nevojshme këmbësorëve për veprimtarinë e tyre në vendbanimin e tyre, por edhe hapësira për ecje të lirë dhe vrapim. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet dy treguesve: 1) % e km të trotuareve të rregulluara dhe 2) % e km të trotuareve të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen (pastrim-fshirje) verore/dimërore.

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e përqindjes së km të trotuareve të rregulluara është 29.34%. Komunitet të cilat kanë përqindjen më të lartë të trotuareve të rregulluara në km janë: Gllgovci (96.33%), Mitrovica jugore 72% dhe Deçani (70%).

Mesatarja e përqindjes së km trotuar të përfshira në mirëmbajtje është 67.83%. Komunitat të cilat kanë përqindjen më të lartë të trotuareve të planifikuara për mirëmbajtje në km janë: Glllogoci, Kaçaniku, Novobërda, Peja, Skenderaj, Shtimja, Shtërpca, Vushtrria, Hani i Elezit, Juniku, Klllokoti, Parteshi, Graçanica, Ranillugu dhe Zveçani (100%), ndërsa komunitat të cilat kanë përqindjen më të ulët të trotuareve të planifikuara për mirëmbajtje në km janë: Mitrovica e Veriut(0%), Ferizaj (0%) dhe Kamenica (9%).




Fig. 23. Performanca e komunave sipas treguesve për trotuaret.


Transporti publik komunal- Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet dy treguesve: 1) % e fshatrave të përfshirë në transportin publik komunal; 2) % e vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim.

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e përqindjes së përfshirjes së fshatrave në transportin publik komunal është 70.79%. Komunitat të cilat kanë përqindjen më të lartë të përfshirjes së fshatrave në transportin publik komunal janë: Fushë-Kosova, Obiliqi, Peja, Mamusha dhe Juniku (100%), ndërsa komunitat të cilat kanë përqindjen më të ulët të përfshirjes së fshatrave në transportin publik komunal janë: Mitrovicë e Veriut, Klllokot, Graçanicë dhe Partesh (0.0%).

Mesatarja e përqindjes së vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim është 51.89%. Komunitat të cilat kanë përqindjen më të lartë të vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim janë: Fushë-Kosova, Lipjani, Mitrovica e Veriut, Hani i Elezit, Mamusha, Graçanica (100%), ndërsa komunitat të cilat kanë përqindjen më të ulët të vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim janë: Zubin-Potoku dhe Parteshi (0.0%).

Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave për këtë fushë është 61.34%.

Fig. 24. Performanca e komunave sipas treguesve për transportin publik lokal.



Parkingjet publike-Komunat kanë ndërmarrë masa të caktuara, por ende të pamjaftueshme në ofrimin e mundësive për parkim të veturave në parkingjet publike. Matja e performancës së komunave në këtë fushë bëhet nëpërmjet pesë treguesve: 1) Numri total i parkingjeve publike (në rrugë dhe jashtë rrugëve); 2) Numri total i parkingjeve publike të shenjëzuara (në rrugë dhe jashtë rrugëve); 3) Numri total i vendparkimeve publike (në rrugë dhe jashtë rrugëve); 4) % e parkingjeve publike me shenjëzim horizontal dhe vertikal; 5) % e parkingjeve publike me vendparkime të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar.

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komuna është **2897**. Mesatarja e numrit të parkingjeve publike në komuna është 76.24%. Komunat të cilat kanë numër më të madh të parkingjeve publike janë: Mitrovica jugore (1530 parkingje), Prizreni (630), ndërsa komunat të cilat kanë numër më të vogël të parkingjeve publike janë: Parteshi, Kllokoti, Deçani, Juniku dhe Mamusha, Hani i Elezit, Malisheva, Rahoveci, Klina dhe Shtërpçë.

Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike të shenjëzuara në komuna është 2018. Mesatarja e numrit të parkingjeve publike të shenjëzuara në komuna është 53.11%. Mesatarja e përgjithshme e përqindjes së parkingjeve publike me shenjëzim horizontal dhe vertikal është 64.44%.

Komunat të cilat kanë përqindjen më të madhe të parkingjeve publike me shenjzim horizontal dhe vertikal në komuna janë: Glllogoci, Istogu, Fushë-Kosova, Peja, Podujeva, Prizreni, Shtimja, Vitia, Vushtrria, Malisheva, Mamusha, Juniku dhe Zveçani (100%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindje më të vogël të parkingjeve publike me shenjzim horizontal dhe vertikal janë: Mitrovica e Veriut, Parteshi, Klllokoti, Ranillugu, Zubin Potoku. Mesatarja e numrit total të vendparkingjeve publike në komuna është 55.34%.

Përqindja e parkingjeve publike me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar është 27.57%.




Fig. 25. Performanca e komunave sipas treguesve për parkingjet publike.

Ndriçimi publik-Komunat kanë bërë investime të konsiderueshme për të siguruar ndriçim publik në zonat urbane dhe në ato rurale. Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet tre treguesve: 1) % e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total a. Në zonën urbane; 2) % e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total b. Në zonën rurale / fshatra 3) % e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total, në qytet dhe në zonën rurale / fshatra.

Matja e këtyre treguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se përqindja e përgjithshme e km rrugë me ndriçim publik në komuna është 48.79%.

Përqindja mesatare e km rrugë me ndriçim publik në zonat rurale / fshatra është 20.50%. Komunat të cilat kanë përqindje më të lartë të km rrugë me ndriçim publik janë: Klllokoti (100%), Shtërpca (92%), Juniku (79.27%) dhe Gjakova (69.38%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindje më të ulët të km rrugë me ndriçim publik janë: Glllogoci, Kaçaniku, Mitrovica e Veriut, Mamusha dhe Parteshi.

Përqindja e përgjithshme mesatare e km rrugë me ndriçim publik është 32.57%.





Fig. 26. Performanca e komunave sipas treguesve për ndriçimin publik.

Furnizimi me ujë- Matja e performancës së komunave në këtë fushë bëhet nëpërmjet katër treguesve: 1) % e ekonomive familjare të përfshira në sistemin e ujësjellësit; 2) % e vendbanimeve të pajisura/përfshira - me sistem të ujësjellësit; 3) % e pagesave të ujit; 4) % e faturimit të ujit të pijshëm.

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se përqindja e përgjithshme e ekonomive familjare të përfshira në sistemin e ujësjellësit në komuna është 67.84%. Komunitat të cilat kanë përqindjen më të lartë të përfshirjes së ekonomive familjare në sistemin e ujësjellësit janë: Gjakova, Peja, Mamusha, Juniku (100%), Fushë-Kosova (99.19%) dhe Shtimja (97.83%), ndërsa komunitat të cilat kanë përqindje më të ulët të përfshirjes së ekonomive familjare në sistemin e ujësjellësit janë: Dragashi (10.2%) dhe Vitia (24.46%). Mesatarja e përgjithshme e përfshirjes së vendbanimeve në sistemin e ujësjellësit është 56.64%. Përqindja mesatare e përgjithshme e pagesave të ujit është 48.87%. Komunitat të cilat



kanë përqindje më të lartë të pagesave të ujit janë: Kamenica (91.59 %), Shtërpca (87.77%) dhe Dragashi (86.34%), ndërsa komunitat të cilat kanë përqindje më të ulët të pagesave të ujit janë: Novo-Bërda, Vitia, Zubin-Potoku, Mitrovica e Veriut, Mamusha, Kllokoti, Ranillugu dhe Zveçani. Analiza e të dhënave tregon se numri më i madh i komunave ka treguar performancë nën mesatarën e vendit. Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave për këtë shërbim është 54.56%.

Fig. 27. Performanca e komunave sipas treguesve për furnizim me ujë.

Kanalizimi dhe higjiena publike- Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet katër treguesëve: 1) % e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit në Zona Urbane; 2) % e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit në Zona Rurale; 3) % e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit; 4) % e vendbanimeve në komunë të cilat posedojnë sistemin e ujërave të zeza – kanalizimeve.

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përqindjes së ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit – në zonat urbane në komuna është 62.94%. Përqindja e përgjithshme e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit – në zonat rurale në komuna është 48.70%.

Mesatarja e përqindjes së përgjithshme të vendbanimeve në komuna të cilat posedojnë sistem të kanalizimit është 53.39%. Deçani dhe Mitrovica e Veriut nuk kanë sistem të kanalizimit – ujerave të zeza. Përqindja e përgjithshme mesatare e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit – fshatrat dhe qytetet në komuna është 60.77%. Komunitat të cilat kanë përqindje më të lartë të kyçjes së ekonomive familjare në sistemin e kanalizimit janë: Fushë-Kosova, Mamusha dhe Parteshi (100%), Graçanica (95.19%), Ferizaj (93.86%) dhe Podujeva (92.3%), ndërsa komunitat të cilat kanë përqindje më të ulët të kyçjes së ekonomive familjare në sistemin e kanalizimit janë: Deçani, Dragashi, Obiliqi dhe Mitrovica e Veriore.

Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave për ofrimin e këtij shërbimi është 56.45%.





Fig. 28. Performanca e komunave sipas treguesve për kanalizim dhe higjienën publik.

Grumbullimi i mbeturinave- Komunitat dhe kompanitë publike të pastrimit kanë obligim që të rrisin performancën e tyre, për këtë fushë. Të dhënat për performancën e komunave në këtë fushë janë marrë nëpërmjet katër treguesëve: 1) % e ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave; 2) % e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave; 3) % e pagesave të bëra.

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përqindjes së përgjithshme të ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në komuna është 54.06%. Përqindja e përgjithshme e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në komuna është 61.88%. Komunitat të cilat kanë përqindje më të lartë të përqindjes së përfshirjes së vendbanimeve në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave janë: Mamusha, Juniku, Klllokoti, Graçanica, Ranillugu dhe Parteshi (100 %). Ndërkaq mesatarja e përgjithshme e përqindjes së pagesave të bëra për ofrimin e këtij shërbimi është 53.78%.

Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave për këtë shërbim është 56.57%.

Fig. 29. Performanca e komunave sipas treguesve për grumbullimin e mbeturinave.



Deponimi i mbeturinave të ngurta- Komunitat në bashkëpunim me ministrinë përkatëse të linjës dhe Kompania për Menaxhimin e Deponive, kanë ndërtuar vende të caktuara për deponimin e mbeturinave. Në bazë të informatave, jo të gjitha deponitë i plotësojnë standardet përkatëse për deponimin e mbeturinave.

Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet treguesi: 1) sasia e mbeturinave të deponuara për kokë të banorit.

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e mbeturinave të deponuara për kokë të banorit në komuna është 162 kg për kokë të banorit. Komunitat të cilat kanë sasi më të madhe të deponimit të mbeturinave për kokë të banorit janë: Mitrovica e Veriut (526.36 kg / kokë banorit) dhe Zubin-Potoku (468.13 kg / kokë banorit), ndërsa komunitat të cilat kanë sasi më të vogël të deponimit të mbeturinave për kokë të banorit janë: Rahoveci (26.87 kg), Hani i Elezit dhe Juniku (52.6 kg).




Fig. 30. Performanca e disa komunave sipas treguesve për deponimin e mbeturinave

Efikasiteti dhe efektiviteti i komunave

Analizat tregojnë se komunat kanë treguar një shkallë mesatare në ofrimin e shërbimeve komunale për qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit. Komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur një mesatare të performimit të tyre, msa i përket ofrimit të shërbimeve deri në shkallën 54.77%.

Mesatarja e përgjithshme dhe ajo individuale e performancës së komunave tregojnë për një trend pozitiv në ofrimin e shërbimeve komunale për 15 fusha, të cilat maten sipas sistemit të menaxhimit të performancës komunale. Nëse e krahasojmë mesataren e përgjithshme të performancës së ofrimit të shërbimeve për vitet: 2010, 2011 dhe 2012 me atë të vitit 2014, vërejmë se mesatarja e përgjithshme gjithashtu e evidentuar edhe me hulumtimin e opinionit qytetar ishte deri në vlerën 44%. Ndërsa, në vitin 2014, mesatarja e ofrimit të shërbimeve komunale është 54.77%, që i bie se kemi një rritje të performancës deri në 10%.

Gjithashtu, sa i përket shërbimeve administrative komunale, komunat kanë një trend në rritje, sa i përket ofrimit të këtyre shërbimeve në raport me qytetarët. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se shumica e komunave kanë treguar shkallë të lartë të shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve në procedurë administrative në shkallë të parë. Prej gjithsej 1,724,667 kërkesa të pranuar, 1,419,951 kërkesa janë miratuar, ndërsa 16,045 kërkesa janë në proces të shqyrtimit. Prej gjithsej 35 komuna, 23 komuna kanë treguar azhuritete (performancë) të përgjithshëm prej 86.10%, 1 komunë – Glllogoci ka realizuar punën në shkallën 100%, ndërsa 13 komuna kanë treguar azhuritete më të ulët se mesatarja e përgjithshme.

Obligimet e Komunave në Procesin e integrimi Evropiane

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal koordinon procesin e integritit evropian në raport me komunat. Në këtë kuadër, MAPL koordinon aktivitetet edhe me Ministrinë e integrimi Evropiane me qëllim që komunat të kenë informacionin e duhur dhe udhëzimet e mjaftueshme sa i përket obligimeve të tyre nga agjenda Evropiane. Hartimi i raportit është bërë në bazë të planit komunal për marrëveshjen e stabilizim asociimit për vitin 2015 dhe është i ndarë në fushat si vijon:

- Qeverisja e mirë
- Bashkëpunimi i komunave;
- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut;
- Avancimi i politikave publike lokale;
- Siguria e dokumentave;

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 35 komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë që për 3 komunat: Laposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok nuk kanë raportuar

Ky kapitull, pasqyron aktivitetet e komunave për periudhën janar – dhjetor 2014 bazuar në planin komunal për MSA si dhe obligimeve të komunave nga: dialogu për liberalizimin e vizave, adresimin e sfidave nga raporti i progresit si dhe procesi i dialogut për stabilizim-asociim.

1. Qeverisja e mirë dhe administrata lokale

Sa i përket buxheteve komunale, menjëherë pas konstituimit të kuvendeve të Komunave, të gjitha komunat e republikës së Kosovës kanë miratuar buxhetet e tyre.

Sa i përket performancës në punë dhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarë vërehet progres i theksuar, ku të gjitha komunat (përveç komunave Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Laposaviq dhe Zveçan) në përgjithësi kanë bërë ngritje të performancës në punë dhe në ofrimin e shërbimeve, si dhe thjeshtësim të proceduarave administrative, si dhe kanë bërë shkurtimin e kohëzgjatjes për ofrimin e shërbimeve komunale.

Po ashtu, fusha e auditimit ka shënuar një progres, sidomos në çështjen e themelimit të Njërive Komunale për Auditim të Brendshëm dhe Komitetit për auditim të brendshëm. Nga 38 komuna

të Republikës së Kosovës, në 34 komuna janë themeluar NJAB, kurse në 30 komuna janë themeluar ndërsa 4 komuna të tjera përfshirë Hanin e Elezit, Shtërpcën, Klokotin dhe Obiliqin ende nuk kanë themeluar Komitetet për Auditim të Brendshëm. Ndërsa sa i përket inventarizimit të pasurisë të gjitha komunat kanë ndërmarrë veprime dhe kanë përfunduar këtë proces. Vetëm komunat si vijon: Malisheva, Ranillugu dhe Parteshi akoma nuk e kanë përmbyllur procesin e inventarizimit.

2. E – qeverisja dhe bashkëpunimi i komunave

Në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës janë krijuar qendrat për ofrimin e shërbimeve për qytetarë “one stop shop”. Të gjitha shërbimet kryhen përmes zyrës për shërbim me qytetarë dhe distribuimi i kërkesave të qytetarëve tek drejtoritë përkatëse bëhet përmes intranetit dhe mënyrave tjera të komunikimit përmes teknologjisë informative. Ndërkaq, nga gjithsej 38 komuna, 5 komuna: Rahovec, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan nuk kanë ofruar përgjigje për veprimet e komunës. Gjithashtu Komunat kanë mirëmbajtur sistemin online të monitorimit të seancave të Kuvendeve të Komunave, ku MAPL ka pasur një qasje të rregullt për monitorimin e tyre. Mirëpo, në disa komuna janë evidentuar vështirësi herë pas here.

Sa i përket bashkëpunimit ndërkomunal dhe binjakëzimit të komunave, bazuar në të dhënat e raportuara nga komunat, shohim se një pjesë e madhe e komunave nuk kanë pasur ndonjë rezultat konkret në këtë fushë, përveç komunës së Lipjanit e cila ka lidhur marrëveshje të bashkëpunimeve ndër-komunale. Ndërsa, lidhur me marrëveshjet e binjakëzimit të komunave të Republikës së Kosovës me komunat e shteteve të rajonit dhe më gjerë, 30 komuna kanë arritur të nënshkruajnë marrëveshje të tilla.

Në vitin 2014, Komunat kanë pasur një bashkëpunim të shtuar me OJQ-të. Lidhur me ndarjen e mjeteve për OJQ-të, sidomos nga fusha e shërbimeve sociale, duhet thënë se në 31 komuna është siguruar buxhet dhe janë realizuar projekte të përbashkëta me OJQ-të.

3. Promovimi i të drejtave të njeriut

Në përgjithësi, në të gjitha komunat NJDNJK-të funksionojnë dhe zhvillojnë aktivitetet promovuese për të drejtat e njeriut në nivelin lokal. Gjithashtu, edhe sa i përket zhvillimit të kapaciteteve profesionale të kësaj fusha, në gjithsej 31 Komuna janë organizuar trajnime dhe aktivitete tjera për rritjen e kapaciteteve për zyrtarët komunal për të drejtat e njeriut.

Sa i përket procesit së vendimmarrjes së grave në nivel lokal, pjesëmarrja e grave nuk është në një nivel të kënaqshëm. Në përgjithësi komunat respektojnë kuotat gjinore, me përjashtim të 4 komunave të cilat kanë një numër simbolik të përfaqësimit të femrave (Komuna e Rahovecit, Dragashit, Klllokotit dhe Ranillugut).

Po ashtu, në fushën e të drejtave të njeriut, sidomos sa i përket veprimeve të ndërmarra në nivel lokal lidhur me personat me aftësi të kufizuara, komunat në përgjithësi kanë shënuar progres. Gjithashtu, komunat kanë shënuar progres edhe sa i përket aktiviteteve promovuese për të drejtat e fëmijëve. Sa i përket të drejtave të komuniteteve RAE, Komunat shumica e komunave kanë miratuar planet komunale të veprimit për komunitetet RAE, ndërsa 3 prej tyre (komuna e Deçanit, Vushtrrisë dhe Istogut) nuk kanë plane të veprimit për komunitetin RAE, si dhe komuna e Istogut nuk ka hartuar dhe publikuar raportin vjetor mbi riintegrimin e komunitetit RAE.

Në fushën e vendbanimeve jo formale shohim se pjesa më e madhe e komunave kanë shënuar progres dhe vetëm 7 komuna kanë pasur probleme dhe sfida. Komuna e Deçanit nuk ka dokument për vendbanimet jo formale; komuna e Drenasit ende nuk ka miratuar planet rregullative për vendbanimet joformale; Komuna e Shtërpçës nuk i ka të përfshira vendbanimet jo-formale në planet rregulluese urbane si dhe komuna e Ranillugut nuk posedon Strategji për vendbanimet jo – formale.

Lidhur me fushën e zbatimit të strategjisë kundër trafikimit me qenie njerëzore, të gjitha komunat, kanë ndërmarrë veprimet për zbatimit të Strategjisë Nacionale kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Planin e Veprimit 2011-2014.

Fusha e decentralizimit të shërbimeve sociale është realizuar në shumicën e komunave të Kosovës, gjë që mund të konsiderohet si një progres. Megjithatë, 4 komuna (komuna e Vitisë, Gjilanit, Ferizajt dhe komuna e Hanit të Elezit) nuk kanë filluar procesin e implementimit të decentralizimit të shërbimeve sociale dhe 1 komunë (komuna e Junikut) nuk ka ofruar përgjigje lidhur me numrin e shërbimeve sociale të decentralizuara plotësisht, pjesërisht dhe atyre që planifikohen të decentralizohen.

Lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale, vërehet se 25 komuna kanë shënuar progres në miratimin e rregulloreve për shërbime sociale. Megjithatë, në 6 komuna ende nuk janë miratuar rregulloret për shërbime sociale sa i përket kësaj fushe, si në: Junik, Gjakovë, Hani i Elezit, Kamenicë, Klllokot dhe Ferizaj. Edhe tek fusha e politikave sociale, vërehet një progres i theksuar tek shumica e komunave. Megjithatë, 2 komuna (komuna e Fushë Kosovës dhe

Malishevës) nuk është ndërmarr ndonjë aktivitet për të ngritur kapacitetet lokale dhe të partnerëve social për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave sociale.

Sa i përket hartimit të strategjive për objekte kolektive, bazuar në të dhënat për strategjinë për objekte kolektive, shohim se nga 38 komuna vetëm komuna e Parteshit nuk ka objekte kolektive banesore.

Ndërsa, sa i përket fushës së kthimit dhe ri-integrimit, komunat kanë ndërmarrë disa veprime lidhur me kthimin dhe ri-integrimin. Në përgjithësi komunat kanë ndërmarrë veprime për ofrimin e ndihmës, përkrahjes dhe mbrojtjes së viktimave, përfshirë edhe ri-integrimin e viktimave pas kthimit.

Në përgjithësi, komunat kanë shënuar progres edhe në respektimin e dygjuhësisë dhe sipas të dhënave nga komunat, në vitin 2014, vetëm në 10 komuna janë evidentuar sfida që ndërlidhen me përdorimin dhe rregullores për përdorimin e gjuhëve zyrtare. Në komunën e Deçanit mungon Komisioni/Grupi për monitorimin e publikimit të dokumenteve në gjuhët zyrtare. Komuna e Drenasit, Malishevës, Gjakovës dhe Hanit të Elezit nuk kanë përkthyes në gjuhën zyrtare. Komuna e Shtërpçës lidhur me publikimin e dokumenteve në gjuhët zyrtare nuk e ka të themeluar grupin për publikimin e dokumenteve. Në komunën e Junikut dhe Shtimes nuk zbatohet rregullorja për përdorimin e gjuhëve zyrtare, ndërsa në komunën e Gjakovës dhe Malishevës rregullorja për përdorimin e gjuhëve zyrtare zbatohet pjesërisht, si dhe komuna e Prishtinës, Mitrovicës Veriore, Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Zveçanit nuk kanë ofruar të dhëna lidhur me zbatimin e rregullores për përdorimin e gjuhës zyrtare.

4. Zhvillimi lokal

Në fushën ambientin biznesor, vërehet se shumë pak komuna kanë shënuar progres. Në total, 14 komuna, (Deçanit, Malishevës, Hani i Elezit, Dragashit, Istogut, Ranillugut, Shtërpçës, Fushë Kosovës, Rahovecit, Klllokotit, Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit) nuk kanë bërë analizën komunale të ambientit biznesor, sfidave dhe mundësive në territorin e tyre, si dhe nuk kanë mbajtur trajnime në këtë fushë. Po ashtu, komunat kanë pasur për detyrë që të krijojnë zyra komunale për promovimin e investimeve, gjë që në këtë drejtim, shohim se në 14 komuna (Mitrovica Veriore, Peja, Fushë Kosovë, Vitisë, Novobërdës, Gjakovës, Prizrenit, Kamenicës, Ferizajt, Hanit të Elezit, Dragashit, Istogut, Ranillugut, Vushtrrisë dhe Klllokotit) nuk është krijuar zyra për promovimin e investimeve, e cila shërben si udhërrëfyes për investitorët vendor dhe ata ndërkombëtar, të cilët dëshirojnë të fillojnë aktivitetet e tyre afariste brenda komunës.

Në fushën e politikave fiskale shohim se nga 38 komuna vetëm 3 komuna (komuna e Junikut, Mitrovicës, Rahovecit) nuk kanë mbajtur trajnime për punonjësit e komunës dhe të partnerëve social për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave fiskale.

Në kuadër të bashkëpunimit të partneritetit publiko – privat, Komunat kanë avancuar bashkëpunimin me sektorin privat në përgjithësi. Sipas të dhënave të raportuara nga Komunat, vetëm 5 komuna (komuna e Junikut, Mitrovicës, Graçanicës, Fushë Kosovës dhe Klinës) nuk aplikojnë partneritetin publiko – privat në kuadër të aktiviteteve të tyre.

Lidhur me menaxhimin e mbeturinave, në përgjithësi komunat kanë pasur progres. Megjithatë, disa komuna vërehen se nuk kanë hartuar plane komunale për menaxhimin e mbeturinave ndërsa 5 komuna ende nuk e posedojnë Planin e Veprimit për Menaxhimin e Mbeturinave: Shtërpçë, Gjilan Kamenicë, Viti dhe Mamushë.

Komunat kanë obligim që të hartojnë planet komunale për energji efikiente. Në përgjithësi, komunat kanë shënuar progres në hartimin e këtyre planeve dhe shumë komuna janë në proces të hartimit të këtyre planeve.

Sa i përket ndotjes akustike në komuna, bazuar në informatat të cilat i posedojmë 11 komuna (Suhareka, Drenasi, Juniku, Mitrovica, Shtime, Prishtina, Obiliqi, Vushtrria, Malisheva, Mamusha dhe Skenderaj nuk e kanë miratuar Rregulloren për menaxhimin e ndotjes akustike.

5. Avancimi i politikave të arsimit

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve dhe implementimin e reformave në arsim, duhet cekur se nga gjithsej 38 komuna, 6 prej tyre (Drenas, Klinë, Podujevë, Pejë, Junik dhe Shtërpçë) nuk kanë hartuar Rregullore për përfshirjen e sektorit privat në hartimin dhe zbatimin e politikave arsimore, 1 komunë (Suhareka) nuk ka plan për ndërtimin e kapaciteteve për implementimin e reformave në arsim, 1 komunë (Shtërpca) nuk e ka mbështetur arsimin parashkollor. Ndërsa, 6 komuna (Mitrovicës, Graçanicës, Mitrovicës Veriore, Laposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit) nuk kanë ofruar përgjigje lidhur me hartimin e rregulloreve për përfshirjen e sektorit privat në hartimin dhe zbatimin e politikave arsimore.

6. Prona komunale dhe ndërtimet

Sa i përket bazës së të dhënave elektronike për menaxhimin e tokës, vërejmë se komunat në përgjithësi kanë pasur progres gjatë vitit 2014. Megjithatë, 7 komuna kanë një ngecje dhe atë komuna e Fushë Kosovës ende nuk e ka funksionalizuar pjesën teknike të bazës së të dhënave

elektronike për menaxhimin e tokës komunale. Ndërsa, komuna e Shtërpçës nuk ka publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës të dhënat për pronën komunale. Kurse, komunat: Klllokot, Kaçanik, Istog, Skenderaj dhe Shtime nuk posedojnë bazën e të dhënave për menaxhimin e tokës.

Gjithashtu, ndërtimet e paligjshme mbesin akoma një sfidë për komunat. Komunat kanë filluar procesin e legalizimit dhe tashmë të gjitha komunat janë në procesin e evidentimit të ndërtimeve pa leje, në kuadër të territorit të tyre. Megjithatë, komunat me zonat urbane më të mëdha kanë më së shumti probleme sa i përket parandalimit të ndërtimeve pa leje.

7. Siguria e dokumentacionit

Sa i përket sigurimit fizik të dokumentacionit, në përgjithësi komunat kanë avancuar në këtë fushë. Përveç komunës së Shtërpçës e cila ngritjen e nivelit të sigurimit fizik të dokumentacionit e ka në gjendje jo të mirë dhe komuna e Ferizajt e cila nuk e ngritur nivelin e sigurimit fizik të dokumentacionit të gjendjes civile, komunat tjera në përgjithësi kanë shënuar progres. Përveç kësaj, të gjitha komunat kanë caktuar zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pikë e rëndësishme është edhe regjistri për të vdekurit në kuadër të gjendjes civile, ku nga të dhënat shohim se të gjitha komunat posedojnë këtë regjistër, përveç komunës së Podujevës e cila nuk posedon bazën e të dhënave mbi numrin e të vdekurve të regjistruar në këtë komunë.

8. Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komuna

Bazuar në obligimet nga agjenda evropiane, komunat duhet të hartojnë planet komunale për trashëgiminë kulturore. Lidhur me këtë, 30 komuna kanë hartuar planet e tyre ndërsa komuna e Deçanit, Graçanicës, Klinës, Mamushës, Lipjanit nuk kanë hartuar planet lokale për trashëgiminë kulturore.

Shpenzimet e Buxheteve Komunale

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal bazuar në mandatin e saj ligjor si dhe planin vjetor të punës për vitin 2015 ka përgatitur raportin e shpenzimeve komunale për vitin 2014 krahasuar me buxhetin sipas kategorive ekonomike.

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) - Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, Komunitet e Republikës së Kosovës për vitin 2014 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 392,727,929.79 € ose 88% e buxhetit të planifikuar në vlerë prej 445,950,442.44 €.

Buxheti i komunave për vitin 2014 është me i madh për 24,610,263.45€ krahasuar me vitin 2013 (viti 2014 - 445,950,442.44 € ndërsa viti 2013 - 421,340,178.99 €).

4.1. Shpenzimet krahasuar me buxhetimin

Buxheti i komunave të Republikës së Kosovës sipas kategorive ekonomike në përgjithësi është shpenzuar si vijon: kategoria e rrogave dhe pagave është planifikuar në vlerë prej 230,571,847.61€, ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 228,561,825.06 €, ose 99%; kategoria e mallrave dhe shërbime është planifikuar në vlerë prej 45,222,642.37€ ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 35,611,025.81€ ose 79%; shpenzimet komunale të planifikuara në vlerë prej 10,286,254.06€ janë shpenzuar 8,723,348.08€, ose 85%; subvencione dhe transfere të planifikuara në vlerë prej 14,562,524.08€ janë shpenzuar 12,814,762.47€ ose 88%; dhe kategoria e shpenzimeve kapitale të planifikuara në vlerë prej 145,307,174.32€ është shpenzuar 107,016,968.37€, ose 74%.

Nëse i krahasojmë kategoritë ekonomike atëherë shohim se kategoria e rrogave dhe pagave është shpenzuar më së shumti (99%); ndërsa më së paku është shpenzuar kategoria e shpenzimeve kapitale (74%) krahasuar me buxhetimin.

Kategoria e rrogave dhe pagave krahasuar me planifikimin është shpenzuar në 38 komuna prej 88 %– 100 % te nivelit vjetor.

Kategoria e mallrave dhe shërbimeve krahasuar me buxhetimin është shpenzuar në nivelin nga 80% - 91% në 23 komuna; në 14 komuna në nivelin prej prej 69% - 79%; Vlen të theksohet se komuna e Leposaviqit ka shpenzuar me se paku 33% të nivelit vjetor të buxhetuar.


Kategoria e Shpenzimeve Komunale krahasuar me buxhetimin është shpenzuar në nivelin 91% - 100% në 6 komuna; në 20 komuna është shpenzuar në nivelin 81% - 89%; në 5 komuna në nivelin 76%-79%; 5 komuna në nivelin 53%-68%. Këtu vlen të ceket se komuna e Zveqanit me 31% shpenzim dhe komuna e Zubin Potokut me më së paku, 10% shpenzim të nivelit vjetor të buxhetuar.

Kategoria e Subvencioneve dhe transfereve krahasuar me planifikimin është shpenzuar në nivelin 90% - 100% në 25 komuna; në 6 komuna është shpenzuar në nivelin 75% – 80%; në 3 komuna në nivelin 47%– 59%; në komunën e Shtërpcës është shpenzuar 19% krahasuar me buxhetimin; dhe në 3 komuna tjera me zero shpenzim (komuna e Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit).


Kategoria e Shpenzimeve kapitale (pasuritë jofinanciare) krahasuar me planifikimin është shpenzuar në 11 komuna 91% - 99%; në 13 komuna është shpenzuar 80% – 89%; në 11 komuna është shpenzuar 59% – 79%; dhe në 3 komuna është shpenzuar nën 50% (komuna e Prishtinës ka shpenzuar 45%; komuna e Leposaviqit 28% dhe komuna e Parteshit ka shpenzuar 24% të nivelit vjetor të buxhetuar.

Komunat të cilat kanë arrit të shpenzojnë në total buxhetin në nivel më të lartë prej 90% - 98% të nivelit vjetor të buxhetuar janë 28 komuna; dhe përqindja më e vogël e shpenzuar është në komunën e Leposaviqit (69%) dhe Prishtina (70%).

4.2. Paraqitja grafike e shpenzimeve komunale për vitin 2014



4.3. Paraqitja grafike e shpenzimeve komunale sipas kategorive ekonomike



KONKLUZIONE

1. Afatet dhe njoftimet për mbledhje të kuvendeve kryesisht janë respektuar, ndërsa njoftimi i MAPL-, në disa raste komunat nuk kanë dërguar ftesën për mbledhje të kuvendit.
2. Në komunën e Pejës dhe Klinës nuk ka funksionuar sistemi i teleprezencës me qëllim të monitorimit të mbledhjeve të kuvendeve të komunave.
3. Ende nuk është themeluar Komiteti për Komunitete në Komunën e Mitrovicës Veriore.
4. Komunat janë kujdesur të mbajnë takime publike me qytetarë, si dhe takime të tjera rreth hartimit të akteve komunale, rregulloreve, diskutimet buxhetore, planeve të caktuara, ndërsa tubimet publike nuk janë mbajtur në komunat: Fushë Kosovë, Suharekë, Novobërdë, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë Veriore.
5. Kryetarët e komunave: Klinë, Novobërdë, Zubin Potok, Partesh, Graçanicë dhe Klllokot, nuk kanë raportuar para kuvendit të komunës Aktet e miratuara në kuvendet e komunave pjesërisht janë publikuar në faqet zyrtare elektronike, ndërsa komunat të cilat kanë treguar performancë të mirë në publikimin e akteve në gjuhët zyrtare janë: Prizreni, Kamenica, Ferizaj, istogu, Graçanica dhe Mitrovica Jugore.
6. Publikimin e akteve në gjuhët zyrtare nuk e kanë bërë komunat: Prishtinë, Klinë, Mamushë, Deçan, Junik, Viti, Podujevë, Hani i Elezit, Kaçanik, Shtime, Skenderaj, Glllogoc, Suharekë, Obiliq, Malishevë, Vushtrri, Novobërdë, Leposavic, Zvecan, Mitrovicë Veriore, Rahovec, Gjakovë, Gjilan dhe Partesh.
7. Komunat nuk kanë dërguar me rregull listën e akteve të nxjerra nga kryetari dhe kuvendi i komunës;
8. Komunat: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok ende nuk i kanë miratuar vendimet për themelimin e KKSb-ve. Ndërsa, 21 komuna tjera kanë dështuar në mbajtjen e 6 takimeve të rregullta sipas udhëzimeve;
9. Komunat Zubin Potok dhe Zvecan nuk kanë raportuar për obligimet nga agjenda Evropiane;
10. Në përgjithësi, komunat kanë shënuar progres në përmbushjen e detyrimeve për të drejtat e njeriut por vërehet se përfaqësimi i grave nuk është në një nivel të kënaqshëm;
11. Komunat nuk kanë lidhur marrëveshje të bashkëpunimit ndër-komunal për ofrimin e shërbimeve
12. Është shënuar një rritje prej 5% e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve komunale;
13. Është shënuar një shkallë e lartë dhe e kënaqshme e shpenzimit të buxheteve komunale;
14. Vërehet një mungesë e planifikimit të drejtë dhe menaxhimit të projekteve kapitale në komuna;

REKOMANDIME

1. Ftesa dhe materialet e mbledhjes së kuvendi të komunës duhet të dërgohen me kohë në MAPL, anëtarëve të kuvendit si dhe grupeve të interesit, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
2. Në të gjitha rastet organet e komunës – zyrtarët përgjegjës janë të obliguar të mirëmbajnë dhe funksionalizojnë pajisjet elektronike për monitorim të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave me qëllim të sigurimit të monitorimit të mbledhjeve nga zyrtarët e MAPL-së konform U.A Nr. 2012/01 për monitorimin e kuvendeve të komunave përmes pajisjeve të teknologjisë informatave “Teleprezencave”. Në rast të mosfunksionimit komunat të njoftojnë me kohë MAPL-në për problemet teknike në mënyrë që mbledhjet të monitorohen përmes pranisë fizike të monitoruesve.
3. Të mbahen takime publike gjithëpërfshirëse me qytetarë së paku 2 herë brenda vitit. Në këto takime është e domosdoshme të marrin pjesë zyrtarët e lartë të komunës, përfshirë kryetarin e komunës, kryesuesin e kuvendit, drejtorët e drejtorive etj.
4. Kryetarët e komunave të raportojnë në baza të rregullta ose kurdo që kërkohet nga kuvendi i komunës.
5. Pjesëmarrja e kryetarëve të komunave – ekzekutivit në mbledhjet e kuvendeve të komunave është e domosdoshme për arsye se ndikon në procesin e vendimmarrjes dhe zbatimin e akteve të miratuara.
6. Të gjitha aktet e miratuara në kuvendin e komunës si dhe aktet e kryetarit të komunës të publikohen në faqet zyrtare elektronike të komunave në gjuhët zyrtare ashtu siç parashihet me Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve.
7. Kryetarët e komunave duhet të dërgojnë në MAPL listën e të gjitha akteve të kuvendit të komunës dhe kryetarit të komunës të miratuara në muajin paraprak, deri më datën 10 të çdo muaji ashtu siç parashihet me LVL.
8. Komunat duhet të evidentojnë pronat komunale, të hartojnë regjistrin e tyre dhe të publikojnë pronat e dedikuara për dhënie në shfrytëzim në faqen zyrtare elektronike të komunës.
9. Kryesuesit e kuvendeve të komunave në të gjitha rastet para miratimit të akteve duhet të verifikojnë kuorumin e mjaftueshëm.
10. Në të gjitha rastet para miratimit të akteve, kryesuesi i kuvendit të komunës duhet të verifikoj nëse ndonjë anëtar i kuvendit të komunës ka konflikt interesi për çështjen që vendoset.
11. Në të gjitha rastet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm organet e komunës janë të obliguara ti respektojnë simbolet shtetërore dhe komunale.
12. Me rastin e miratimit të akteve, kuvendet e komunave duhet të sigurohen paraprakisht se janë kompetente për miratimin e tyre.
13. Komunat duhet të respektojnë parimet , kriteret dhe procedurat me rastin e vendosjes së bashkëpunimit ndër-komunale si dhe bashkëpunimit komunal ndërkombëtar.
14. Komunat duhet të respektojnë kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve në afatin e paraparë ligjor, me qëllim të harmonizimit të akteve konform legjislacionit në fuqi.

15. Kuvendet e komunave të shfuqizojnë aktet e kundërligjshme brenda afatit 30 ditor pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim nga autoriteti mbikëqyrës.
16. Komunitat të shfrytëzojnë mundësinë e konsultimit paraprak në rastet kur kanë paqartësi gjatë procesit të hartimit të akteve të organeve të komunës.
17. Të respektohen parimet, kriteret dhe procedurat ligjore me rastin e hartimit dhe miratimit të akteve juridike nënligjore. Aktet e kuvendeve të komunave të jenë në përputhje me standardet dhe teknikat e hartimit të akteve sipas Rregullores Nr.01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave.
18. Në të gjitha rastet organet e komunave janë të obliguara t'i respektojnë parimet, kriteret dhe procedurat ligjore për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.
19. Koordinatorët e KKSBB-ve në komuna duhet t'i dërgojnë me kohë njoftimet dhe materialet për mbledhjet e KKSBB-ve. Gjithashtu duhet të dërgohen procesverbalet nga mbledhjet e KKSBB-ve.
20. Komunitat duhet të miratojnë planet e punës për KKSBB për vitin 2015 dhe të përcjellin zbatimin e këtyre planeve, të raportojnë në kuvendin e komunës për zbatimin e planeve të punës si dhe sigurojnë zbatimin e përgjegjësive që dalin për sigurinë në bashkësi.
21. Të rritet përfaqësimi gjinor në Komuna;
22. Të rriten iniciativat e bashkëpunimit ndër-komunal;
23. Ti kushtohet kujdes planifikimit të buxhetit në rritjen e kategorisë së investimeve kapitale.
24. Të bëhet një planifikim dhe menaxhim i mirëfilltë i investimeve kapitale dhe kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.